



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2795/prot.
3

Urë Vajguore, më 14.10.2024

VENDIM

Nr. 43 Datë 14.10.2024

“Për miratimin e hapjes për 4 (pozicione të reja pune) , në Sektorin e Arsimit Kulturës dhe Sportit dhe 2 (pozicione të reja pune), në Sektorin e Qendrës komunitare Multifunkionale, Bashkia Dimal”.

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Shërbimeve Mbështetëse, Marrëdhënien me Publikun, Ndhima Ekonomike dhe PAK pranë Bashkisë Dimal, në mbështetje Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Neni 23 pika 12 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, Ligjit nr 69/2012 “Për sistemin Arsimor Parauniversitar”, Udhëzimit Nr.30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve nëpër klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e Arsimit Parauniversitar “, Ligjit nr 32 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion “, VKM-së nr 1062 datë 23.12.2015 “Për miratimin e rrgullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion”, si dhe në kuadër mirëfunksionimit të institucioneve arsimore parashkolllore në juridiksion të Bashkisë Dimal, kontrollit teknik për sistemin e ngrohjes dhe jo vetëm , kërkesës nr 2575 prot datë 11.09.2024, kërkesës nr 2587 prot datë 11.09.2024 të sektorit të Arsimit Kulturës dhe Sportit, Ligjit nr 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM-ja nr 518 datë 04.09.2018 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat e Përfitimit të Tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e Shërbimit të organizuar “, relacionit nr 2759 datë 23.09.2024 nga Sektori i Qendrës Komunitare Multifunksonale.

VENDOSI :

Me 14 vota PRO, nga 14 Këshilltarë prezentë:

1. Të miratojë vendimin për shtimin e strukturës në Sektorin e Arsimit Kulturës dhe Sportit për 4 (katër) pozicione dhe 2 (dy) pozicione të reja pune në Sektorin e Qendrës Komunitare Multifunkionale.

1. Edukatore në Kopshtin Qendër
2. Sanitare
3. Teknik i mesëm për mirëmbajtjen e kaldajave
4. Specialist i mesëm Elektriçist
5. Kujdestarë për rastet emergjente tetraplegjikë, dhe personave të tjerë me aftësi ndryshe të braktisur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
AVDULLA SALILLARI

